



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

U R D H Ë R

Nr. 35, datë 27.1.2004

PËR

MASAT E SIGURISË NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR
“NËNË TEREZA”

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës,

U R D H Ë R O J:

1. Ndarjen e sallës “VIP” të aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza”, në Rinas, në dy pjesë, për rritjen e sigurisë në këtë aeroport.
2. Salla “VIP1” të përdoret vetëm për shërbime ndaj autoriteteve të larta të shtetit, Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryetarit të Parlamentit, sipas përcaktimeve në konventat e Vjenës, aneksi 17 i ICAO-s, e të Çikagos dhe të gjitha standardeve, të përfshira në manualin e sigurisë së ICAO-s.
3. Salla “VIP 2”, ku do të vendosen edhe kamerat e kontrollit (CCTV), të përdoret për të gjithë personat e cilësuar “VIP”, të përcaktuar në listën e protokollit të shtetit, të cilët do t’u nënshtrohen kontrollit të sigurisë. Ky kontroll të kryhet me skanim dhe kontroll të plotë në zonën përpara platformës së vendqëndrimit të avionit.

Z. Kaur
Protokollo
Mj. D. kopje
fuarant
Tribit.
dt. 02.04
Cks

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, Drejtoria e Protokollit të Shtetit, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Drejtoria e Albtransportit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



KRYEMINISTRI

FATOS NANO